



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, të Ligjit nr. 03/ L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 04.09.2023, merr këtë

V E N D I M

I.

MIRATOHET raporti me nr. ref. 14-020/04-0171429/23, i datës 15.4.2023 i Komisionit Profesional për Verifikimin e Shfrytëzimit dhe të Statusit të banesave në Bregun e Diellit, Fushën e Pajtimit dhe në Hajvali.

II.

Duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në Raportin, sipas pikës 1. të këtij vendimi, obligohet Kryetari i Kryeqytetit dhe drejtoritë tjera përkatëse të përcaktuara me këtë vendim, që t'i ndërmarrin veprimet si në vijim:

1. Obligohet Drejtoria e Mirëqenies Sociale që, në një afat prej 30 ditësh nga dita e publikimit të këtij vendimi, të kryejë verifikimin e statusit social të familjeve të vendosura në njësitë banesore të Komunës së Prishtinës, të cilat janë ndarë atëherë për kategoritë sociale, si dhe të vlerësojë nëse kanë zgjidhur çështjen e banimit.
2. Drejtoria është e obliguar që Kryetarit të Kryeqytetit t'ia përcjellë listën e familjeve që duhet t'ju vazhdohet kontrata e dhënies në shfrytëzim sipas kushteve të përcaktuara, si dhe nëse ka raste që duhet t'i lirojnë banesat, duhet t'i arsyetojë me shkrim secilin rast veç e veç, për të treguar arsyen pse nuk duhet t'i vazhdohet kontrata e dhënies në shfrytëzim familjeve përkatëse.
3. Obligohet Kryetari i Kryeqytetit që rastet të cilat i plotësojnë kushtet për të qëndruar në njësitë banesore sipas vlerësimit të Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, t'i vazhdojë kontratat e dhënies në shfrytëzim.
4. Obligohet Komuna e Prishtinës që në bashkëpunim me Ndërmarrjen Publike Banesore që të mirëmbajë blloqet banesore të Komunës së Prishtinës, të cilat janë të dedikuara për kategorinë e banimit social.

III.

1. Për kategoritë e familjeve të dëshmorëve dhe heronjve, banesat janë dhënë në shfrytëzim nga Kuvendi i Kryeqytetit atëherë për shkak të meritave të tyre në luftën tonë për liri dhe pavarësi, prandaj, obligohet Kryetari i Kryeqytetit që për këto kategori t'u vazhdojë kontratat në periudhë afatgjatë.
2. Banesat e dhëna në shfrytëzim për kategoritë e shërbyesve civilë, të këshilltarëve komunalë (zyrtarëve komunalë), pjesëtarëve të policisë së Republikës së Kosovës, pjesëtarë të ish-Trupave Mbrojtëse të Kosovës dhe të veteranëve të luftës, të cilëve u ka skaduar afati i dhënies në shfrytëzim, duhet të verifikohen nëse të njëjtët kanë bërë zgjidhje të banimit.
3. Themelohet një Komision nga Kuvendi i Kryeqytetit në pajtim me Rregulloren e miratuar në Kuvend të Kryeqytetit, i cili në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse të Kryeqytetit, do të bëjë verifikimin sipas pikës 2 të këtij neni. Ky Komision do të ketë edhe mandatin që të përgatitë gjithë procedurën për thirrjen publike dhe vlerësimin e aplikimeve, për ndarjen e banesave të cilat mbesin të lira.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Kryeqytetit, Drejtoria e Pronës, Drejtoria e Inspektoratit, Zyra ligjore dhe Drejtoria e Financave.

V.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-035/01-183659/23, më 05.09.2023

KRYESUESI I KUVENDIT
Pëllumb Bajraktari

